



THIRRJE PËR PJESËMARRJE NË WORKSHOPIN

“Mësimdhënia e historisë dhe e gjeografisë: Sfidat e sotme dhe drejtimit e së ardhmes”

Në datën 4 prill 2025, ora 14:00, në mjediset e bibliotekës “Kongresi i Manastirit”, Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë, Departamenti i Historisë dhe i Gjeografisë, do të organizojë workshopin me temë **“Mësimdhënia e historisë dhe e gjeografisë: Sfidat e sotme dhe drejtimit e së ardhmes”**, me pjesëmarrjen e mësuesve të profilit të Historisë dhe Gjeografisë në arsimin parauniversitar (mësuesit e gjimnazeve dhe shkollave nëntëvjeçare) në qarkun e Korçës.

Kjo veprimtari organizohet me qëllim diskutimin e çështjeve që trajtohen në disiplinat e historisë dhe të gjeografisë, vendi që zënë ato në kurrikulën e arsimit parauniversitar, promovimit të këtyre disiplinave dhe rritjen e interesit tek të rinjtë, si edhe në kuadër të forcimit e bashkëpunimit midis departamentit të Historisë dhe gjeografisë, mësuesve dhe Alumni.

Qëllimi i workshopit është adresojmë disa probleme që lidhen mësimdhënien e historisë dhe gjeografisë në arsimin parauniversitar, si dhe rritja e rolit të disiplinave të historisë dhe gjeografisë në formimin profesional dhe qytetar të nxënësve nëpërmjet përmirësimeve në kurrikulën e arsimit.

Temat e diskutimit:

- Vendi që zë gjeografia dhe historia në kurrikulën e arsimit;
- Rëndësia e disiplinave të historisë dhe gjeografisë në kurrikulën e arsimit parauniversitar;
- Metodologjitë bashkëkohore në mësimdhënien e historisë dhe gjeografisë dhe përdorimi i tyre në procesin e mësimdhënies;
- Rritja e rolit të mësuesit të historisë dhe gjeografisë në procesin e mësimdhënies dhe trasmetimit të njohurive;
- Trajtimi i çështjeve historike dhe gjeografike në disiplinat e tjera;
- Edukimi informal pjesë e procesit të mësimdhënies së historisë dhe gjeografisë;
- Nxitja e interesit të nxënësve kundrejt disiplinave të historis dhe gjeografisë;
- Sfidat me të cilat përballen mësuesit e historisë dhe gjeografisë në zbatimin e kurrikulës dhe në procesin e mësimdhënies





Objektivat që kërkohet të arrihen nëpërmjet realizimit të Workshop-it:

- Të diskutohet në lidhje me vendin që zënë disiplinat e historisë dhe gjeografisë në kurrikulën e arsimit parauniversitar;
- Të njihen metodat që përdoren në disiplinat e historisë dhe gjeografisë në procesin e mësimdhënies;
- Të stimulojë interesin e nxënësve dhe të krijojë mjedisin ku nxënësit janë pjesëmarrës aktivë në procesin e të mësuarit dhe ku mësuesit të marrin kënaqësi në procesin e mësimdhënies duke dhënë më të mirët e tyre;
- Të njohë nevojën që kanë mësuesit e historisë dhe gjeografisë për trajnime apo kualifikime profesionale;
- Të nxisë shkëmbimin e përvojës midis mësuesve të historisë dhe gjeografisë në shkollat e qarkut;
- Të forcojë bashkëpunimin midis departamentit të Historisë dhe Gjeografisë UNIKO dhe mësuesve të historisë dhe gjeografisë në qark.

Ju ftojmë të merrni pjesë me diskutimet tuaja duke dërguar titullin e diskutimit, emrin/mbiemrin tuaj, si dhe emrin e shkollës ku jeni punësuar brenda datës **28 mars 2025 në adresën e e-mailit emenkshi@unkorce.edu.al**, ose mund të kontaktoni në **nr. 0695520040** (Prof. as. dr. Edlira Menkshi, përgjegjëse e departamentit të Historisë dhe Gjeografisë).

